



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBETARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Sociologji

Varianti A

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	A	C	C	A	D	C	A	A	D	A

• *Pyetjet me zhvillim*

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.

11. 3 pikë
- a) sistematik ose periodik quhet kur një ose disa dukuri shoqërorevëshrohen disa herë në intervale kohore të caktuara. Krijon mundësi për arritjen e përfundimeve më të thella dhe më të sakta, por kërkon kohë të gjatë shumë punë të studiuesve
- b) i pjesshëm kur vëzhgohet një pjesë e dukurive të së njejtës natyrë ose veprimtaritë e një pjese të individëve të ndonjë grupimi shoqëror.
- c) studiuesi jeton me bashkësinë shoqërore që po studion dhe përfshihet drejtpërdrejt në shumë veprimtari të saj.

12. 2 pikë
- a) fryma kolektiviste – 2 pikë
- me ngjyrimet socialiste u frenuan nismat individuale; fryma kolektiviste synonte të rrafshonte individualitetin e spikatur të shqiptarëve etj.
- në demokraci nxitet shpirti konkurrues, përkrahja e nismave vetjake, etj.
- b) barazia shoqërore – 2 pikë
- me ngjyrimet socialiste ajo kuptohej si barazi në nivelin ekonomik, arsimor, etj.
- si vlerë perëndimore kuptohet si mundësi e barabartë për të gjithë shqiptarët për të përparuar në të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë; respektimi i praktikizmit tregtar,

13. 3 pikë
- a) devijanca parësore – pasi një person etiketohet si devijues, një karakterizim i tillë, bëhet pjesë e identitetit të tij
 - b) devijanca dytësore- profilizohet gjithnjë e më shumë identiteti devijues i individit në vetëdijen e tij dhe në mendimet e të tjrëve
 - c) lidhjet shoqërore sipas teorisë së kontrollit-
 - lidhjet e fortas inkurajojnë frymën e konformitetit
 - lidhjet e dobëta u krijojnë njerëzve më shumë hapësirë për modele sjelljesh devijante
14. lëvizja feministe përveç barazisë ndërgjinore 4 pikë
- a) feminitetet sugjerojnë integrimiin e dy botëve: femërore dhe mashkullore
 - b) tejkalimi i shtresëzimit shoqëror
 - c) shmangia e akteve të dhunës
 - d) përkrahja e lirisë seksuale
15. 3 pikë
- a) shoqërizim i parashikuar - proces i të menduarit dhe i përshtatjes me pikësynime për të arritur statuse dhe role të caktuara në të ardhmen
 - b) opinion publik - tërësi pikëpamjesh të shumicës së njerëzve të një shoqërie për jështje të ndryshme, veçanërisht për ato të diskutueshme.
 - c) personalitet- sistem i organizuar i mendimeve, ndjenjave dhe sjelljeve personale
16. 3 pikë
- a) uniteti shoqëror dhe burim konfliktesh.
 - b) kontrolli shoqëror
 - c) krijimi shoqëror i së shenjtës
17. 4 pikë
- a) bashkësi- tip i organizimit shoqëror me solidarësi të fortë të bazuar në tradita dhe lidhje personale
 - b) shoqatë – tip i organizimit shoqëror me solidarësi shoqërore të dobët, si rrjedhojë e shumëllojshmërisë kulturore e nënkulturore, dhe sidomos, e marrëdhënieve shoqërore jopersonale
18. 2 pikë
- a) synojnë të realizojnë ndryshime shoqërore të kufizuara në shoqëri të caktuara të marra si një e tërë
 - b) zbusin pabarazitë shoqërore dhe synojnë të pohojnë modele të reja sjelljeje, të menduari dhe organizimi
19. 2 pikë
- a) pakica kombëtare- grupime të popullsisë të cilat jetojnë brenda një shoqërie tjetër, por që kanë lidhje të ngushta me popullsinë e shtetit amë- fqinjë me të
 - b) pakicat etnike kanë lidhje më të zbehta me shumicën e popullsisë së vet.
20. 2 pikë
- a) individualizimi i mënyrës së jetesës
 - b) shumica kanë mundësi ligjore dhe ekonomike për të përzgjedhur vetë profesionin, vendbanimin, profilin e shkollimit, orientimin politik, stilin e jetesës e ndryshojnë